

VENDIM
Nr.912, datë 19.12.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GREKAN TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Grekan të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Grekan të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.9, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Grekan”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Grekan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Grekan		Lidhja 1
Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës.	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
5, 6	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
7-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
12-18	Shërbim funeral.	Në pronësi
19, 20	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
21-24	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje).	Në përdorim
26, 27, 34-40,44,53-79	Pyje kullota komunale.	Në pronësi
87-131	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuare).	Në pronësi
182-185	Furnizim me ujë të pijshëm.	Në pronësi
137,136,140,138,144-146,148,150,152,153,179	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive, kanale të treta).	Në pronësi
132-135, 139, 141-143, 147, 149, 151	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim